

DITARI
S'shkela rregulla pse takova Limajn

Pavarësisht faktit se kryeministri Hashim Thaçi mostakimin me Limajn e ka arsyetuar me "disa procedura të cilat..."

FAQE 02



DITARI
Jarinje hapet për mallrat komerciale

Pikëkalimi 1 (Jarinje) është hapur për qarkullim të mallrave komerciale si pjesë e procesit të normalizimit të përgjithshëm...

FAQE 08

RAJONI
VV: "Ferronikeli", shembull i dështimit të privatizimit

Florim Kuliqi, kimist, tha se, sipas një studimi botëror, substancat e metaleve, në këtë rast të nikelit...

FAQE 13



Kontratë për heshtjen

FAQE 19

E MARTË, 27 MARS 2012. ÇMIMI 30 CENTË.

NO. 3845, VITI XIV. GAZETË E PËRDITSHME. WWW.ZERI.INFO

ZëRI



like >
facebook.com/gazetazeri

follow >
twitter.com/gazeta_zeri



8° | 19°C

FILLET E IARTE
PRISHTINA SOT

Luajnë me stafin konsullor e diplomatik

Më shumë se 600 kandidatë, të cilët i janë nënshtruar dy testeve kualifikuese për diplomaci dhe shërbime konsullore, janë duke pritur në ankth për më shumë se një muaj shpalljen e rezultateve nga MPJ

Fadil Sertolli

PRISHTINË → Vonesa në shpalljen e rezultateve për staf diplomatik dhe konsullor nga ana e

Ministritë së Punëve të Jashtme ka rritur dyshimet te përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe te përfaqësuesit e opozitës, se emrat që do të publikohen do të jenë të selektuar

dhe të influencuar nga politika. Edhe përkundër garantimit, ditë më parë, nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Ibrahim Gashi, se përzgjedhja e stafit konsullor dhe

diplomatik do të bëhet në mënyrë objektive dhe se gjatë seleksionimit do të respektohet konkurrenca e vlerës, prapëseprapë dyshimet vetëm sa janë rritur. **05**

OPINIONE 10-11

> Një vit i përgjakur i revolucionit sirian
 — QEMAJL MORINA

> Ta pastrojmë Kosovën!
 — BURIM LEÇI

www.zeri.info
 Lexojeni gazetën edhe në internet.

4 195871 701104

Prishtinë · Vienna

038 220 220

KOSOVA AIRLINES eurokoha NIKI

CITROËN C3 1.4 HDI

13.399 €

SHËRËSËMIL | PARË - GRATIS

Oferta speciale - me savi të limituar

DelfinAuto

CITROËN

DELFIN LTD - DELFIN AUTO - Zona Industriale p.n., Vetemik - Prishtinë - Tel. 038 602 702 - 049 550 755

Kliko me Zë.

www.zeri.info

Burim i pashtershëm

Tel: 038/ 550 088

Në emër të popullit*


Nga këshilli, në këshill!

Në Kosovë, sot, do të themelohet edhe një këshill!

Hej, ky është lajm përtej lajmi!

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, pritet të themelojë Këshillin Kombëtar për Integritet Evropian, si një mekanizëm që synon të bashkërendojë dhe krijojë konsensus nacional në lidhje me integritet.

Thuhet se në aktin e themelimit të këtij këshilli do të jetë i pranishëm dhe komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Stefan Fyfe. Ndërkaq, pjesë e tij do të jenë edhe kryeministri Thaçi, kryeparlamentari Krasniqi, lideri i LDK-së Mustafa dhe përfaqësuesit e tjerë të partive



opozitare, si dhe ata të shoqërisë civile.


Qëllimi?

Këshilli synon krijimin e konsensusit të nevojshëm politik në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me integritet evropiane.

Presidentja më herët formoi Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit!

Tash do ta formojë këtë tjetrin!

Njerëz kemi në Kosovë! Për çfarëdo këshillash që formohen, apo jo?



Burim Leci

SALLONET E SË MARTËS

“NISMA GLOBALE PËR PASTRIMIN E TOKËS 2012”. KU MBETET KOSOVA? ”


Ta pastrojmë Kosovën!

Në këtë opinion argumentoj se sjelljet tona të përditshme e kanë degraduar mjedisin në atë masë sa që mirëqenia jonë dhe e gjeneratave të ardhshme vazhdon të cenohet. Pyetja shtrohet se a mund ta ndalim ne këtë ritëm dhe si?

Menaxhimi i mbeturinave

Jemi katandisur në këtë masë me mbeturina të hedhura e të shpërndara edhe më tepër se shtrirja e operatorëve mobilë. Nuk kërkon ekspertizë për të konkluduar se gjithandej nëpër Kosovë ka mbeturina të hedhura, sepse kjo pasqyrohet në çdo cep të vendit dhe na jep një imazh të shëmtuar.

Konsumi ka ndryshuar drastikisht, pothuajse çdo produkt i blerë është i pakeluar, përfshirë edhe pemët e perimet dhe të cilat futen në qese të plastikës. Këto paketime më pas duhet të hidhen e të sistemohen si mbeturina.



Sonte (e martë), në orën 17:45, mbahet Sallonit i radhës me temën: “Imazhi i fshtatrave nga lart: çfarë na tregon planifikimi ynë hapësinor?” (Më shumë informata mund të gjeni në www.d4d-ks.org)

përgjegjshëm ndaj mjedisit.

Pos mbeturinave të hedhura e të grumbulluara gjithandej, së shpejti do të kemi edhe problemin e stërmbushjes së deponive aktuale. Shpëtojme që së shpejti do të procedohet Ligji për menaxhim të mbeturinave, ligj i cili do të mundësojë riciklimin e mbeturinave si dhe përdorimin e tyre për të gjeneruar ngrohje për qytete apo për të gjeneruar energji elektrike nga to. Kjo do të rezultojë me vende të reja punës dhe me mbeturina të menaxhuara sipas standardeve

Janë të pakta ato industri të cilat trajtojnë ujërat para se t'i shkarkojnë ato në lumenj, prandaj shpesh dëgjojmë për peshq të ngordhur. Ujërat tona të zeza shkarkohen në lumenj pa trajtim paraprak. Përveç ndotjeve tona, aty derdhen edhe preparate të ndryshme që ne përdorim në (deterxhentë, shamponë) të cilët përmbajnë kimikale të dëmshme. Bateritë e ndryshme gjithashtu ne i hedhim si çdo mbeturinë tjetër, me pasojë të pariparueshme për ndotjen e tokës, u pajtuam ne apo jo.

Mjedisi është një çështje që tejkalon gjeneratat. Ne nuk ia patëm për borxh gjeneratës së kaluar që ta ndotë tokën me metale të rënda në Trepçë, KEK e Ferronikël. Nuk ia patëm për borxh as që të shkatërrojnë tokën më të mirë me ndërtimin e industrive në tokën më pjellore. Gjenerata jonë është duke e



Rrenë e kulluar - këtë këshill po e formuaka Fyfe, e jo presidentja Jahjaga-



Nga këshilli vijmë, në këshill shkollimë...



Hahahaha, veç këshilla krijo, mos gabo të punosh diçka tjetër, mjaft

ga. Natyrisht, këtu po bëhet çka po thonë ndërkomëtarët. Pikë...

**Namiku
(Prizren)**

eshtë krijimi i keshillave në letër... edhe kjo është punë "pozitive"... Mozomakeq...

**Afrimi
(Gjenevë)**


**Tafili
(Prishtinë)**

* Mos u frikësoni! Nuk po e kthejmë komunizmin! Në rubrikën "Në emër të popullit" do të botohen qasje ironike ndaj ngjarjeve të caktuara në vend e në botë dhe komente të lexuesve të gazetës sonë nga www.zeri.info

**Hashim
Thaçi,
kryeministër i
Kosovës**

“

Nuk pretendoj të kandidoj për postin e presidentit të vendit në zgjedhjet e ardhshme. Nuk i kam në gejff postet ceremoniale, siç është posti i presidentit”



Në vendin tonë ka telashe të shumta (hapësirat e gjelbra edhe ashtu të mangëta nuk mirëmbahen, automobilat parkohen në trotuare, ndriçimi publik nuk funksionon, rrugët janë keq të mirëmbajtura, ndërtime bëhen pa asnjë plan urbanistik, ligji nuk zbatohet. Parregullsitë e shumta krijojnë përshtypje që një mbeturinë e hedhur nuk do të bënte më tepër dëm.

Unë besoj që mund ta ndryshojmë këtë gjendje. Më kujtohet koha kur merrnim shportën në shtëpi për të blerë gjëra në dyqan, qeset e plastikës kanë qenë një komoditet i rrallë dhe tani një ndotje e tepërt. Për shishet e qelqit kemi paguar kaucion, i cili na është kompensuar pas kthimit të shisheve. Shumë vende në botë kanë ndaluar përdorimin e qeseve të plastikës, duke i zëvendësuar ato me qese të letres. Qeveria mund të vendosë edhe komisionin mbi shishe të qelqit, kanaqe të aluminit, por edhe në paketime të tjera.

Besoj se ne mund të ndryshojmë sjelljen ashtu siç e ndryshojmë sjelljen kur ndodhemi jashtë Kosovës. Për çfarë Kosove ne kemi luftuar? Ndryshimi duhet të fillojë nga secili prej nesh dhe të pasohet tek anëtarët e familjes dhe shoqëria e gjerë. Vetëdijesimi merr kohë, por ne duhet të synojmë gjeneratat e reja. Edukimi për mjedisin duhet të fillojë nga parashkollorët dhe të vazhdojë në të gjitha nivelet, dhe me këto veprime sigurohemi që kemi qytetarë të

evropiane.

A e kemi tokën e ndotur?

Diskutimet se a kemi tokën e ndotur apo jo janë bërë pjesë e çdo debati për mjedisin, si pasojë e një raporti i dalë nga një projekt i përkrahur nga Komisioni Evropian. Pa aluduar në vërtetësinë apo jo të këtij raporti është duke pasur edhe anën pozitive sepse na ka bërë të mendojmë dhe të diskutojmë për tokën dhe ndotjen e saj.

Në Kosovë kemi pak tokë pjellore për kokë të banorit. Edhe këtë tokë të paktë pjellore jemi duke e tkurrur me betonime e ndërtime. Në kushte optimale për t'u formuar 2.5 cm tokë pjellore, nevojiten nga 800 deri në 1.000 vjet. Kurse ne, çdo vit shkatërrojmë me mijëra hektarë tokë të punueshme - kjo është bukëpërmbysje.

Mirëpo, t'i kthehem pyetjes se a e kemi tokën e ndotur. Për t'u përgjigjur në këtë pyetje fillimisht t'ia nis nga dy burimet më evidente. Industrinë e mëdha gjatë procesit të prodhimit emetojnë gazra toksike në ajër, të cilat bien mbi tokë duke e kontaminuar atë deri në 30 km. Nëse ujisim tokën nga lumenjtë në të cilët shkarkohen ujërat e patrajtuara industriale apo ujërat e zeza (gjithashtu të patrajtuara) atëherë ajo tokë do të kontaminohet. Nuk ka dëshmi të mjaftueshme se ndotësit më të mëdhenj në Kosovë (KEK-u, Trepça, Ferronikeli dhe Sharrçemi) kanë standarde dhe teknologji moderne.

dëmtuar natyrën edhe më shumë për një kohë shumë më shkurtër. Nuk kemi të drejtë t'i shkatërrojmë dhe pakësojmë resurset natyrore për gjeneratat e ardhme. Nëse ky degradim vazhdon, vetë do të bartim pasojat por edhe pasardhësit tanë do të na mallkojnë pasi që nuk do të kenë jetesë në këtë vend.

Çfarë mund të bëjmë?

Të jemi më të përgjegjshëm për rolin që kemi ne me mjedisin. Të jemi shumë të zëshëm ndaj ndotësve të mjedisit dhe dëmtuesve të resurseve natyrore. Të kërkojmë nga politikanët e nivelit lokal dhe qendror për vizionin dhe strategjinë mjedisore para se t'i votojmë. Të fillohet me edukimin e gjeneratave të reja për kujdesin ndaj mjedisit.

Së fundi, kemi një mundësi të mirë që të fillojmë këtë vit së mbari për të përmirësuar gjendjen mjedisore në Kosovë. Të fillojmë duke iu bashkangjitur fushatës më 24 maj: "Ta pastrojmë Kosovën". Për këtë ditë të mos diskutojmë se ata që i kanë hedhur duhet edhe t'i mbledhin mbeturinat, të mos argumentojmë se janë kompanitë ato që duhet të pastrojnë. Edhe nëse e dimë se ato sërish do të hidhen, për një ditë, t'i përvishemi punës e të pastrojmë Kosovën, duke pastruar lagjet tona. Me këtë veprim do të jemi pjesë e një fushate botërore. Të jetë ky vetëm fillimi.